

Shtojca 2

Aplikacion për dhënie e lejes mjedisore

APLIKACION PËR DHËNIEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	“MIRECO” SH.P.K.
	Vendi	Mitrovicë.
	Adresa	Zona Industriale: Objekti i Trepça Sh.A., Komuna: Mitrovicë.
	Nr. i tel./fax	+383 48 885 666
	E-mail	argjend.halili@horn-co.de.
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	NUI: 811915026 Data e regjistrimit: 23/03/2022
1.1.3.	Personi përgjegjës i kompanisë	Argjend Halili – drejtor.
	Nr. i tel./fax	+383 48 885 666
	E-mail	argjend.halili@horn-co.de.
1.1.4.	Personi kontaktues përgjegjës për mjedis	Argjend Halili
	Nr. i tel./fax	+383 48 885 666
	E-mail	argjend.halili@horn-co.de.
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	Impianti për mbledhjen, grumbullimin, klasifikimin, rikuperimin, thërrmimit-thyerjes, paketimit dhe magazinimit të mbetjeve të tullave zjarrrdurese (refraktare)
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Zona Industriale: Objekti i Trepça Sh.A., Komuna: Mitrovicë, Zona Kadastrale: Shupkovc.

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

2.1.	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	Lokacioni gjendet në zonën industriale të kompleksit Trepça Sh.A. në Mitrovicë. Koordinatat gjeografike janë 42°52'57.6"N dhe 20°52'54.2"E. Impianti është afërsisht 1.7 km larg qendrës së qytetit. Zona është industriale dhe jo bujqësore, me terren kryesisht të rrafshët. Ndodhet në Zonën Industriale të Trepçës në qytetin e Mitrovicës, në zonën kadastrale Shupkovo të Mitrovicës, përkatësisht në ngastrën kadastrale nr. P-71208128-01090-1. Terreni i lokacionit karakterizohet me pjerrësi kontinuale, me rënie rreth 2%, me drejtim të rënies nga lindja në perëndim. Prej vitit 1965 lokacioni ku operon impianti kishte kaluar në zoni industriale në kuadër të shoqërisë aksionare “Trepça”, e cila vazhdon edhe sot e kësaj dite. Për shkak të mos funksionimit zona në tërësi është mbuluar me gjelbërim, gjendje kjo e cila edhe aktualisht ekziston. Parcela në fjalë dhe hapësira për rreth janë hapësirë industriale e nuk janë toka bujqësore. Toka ekzistuese në lokacion si tërësi është me bazë zhavorrike me një shtresë humusore jo më të trashë se 5-10cm si rezultat i bartjeve të lymit ndër vite. Pra toka ekzistuese nuk konsiderohet tokë bujqësore me rendiment të kënaqshme.
------	--	---



Figura 1: Lokacioni i impiantit

Lokacioni i projektit për “*Impianti për Deponimin e Materialeve Zjarrduruese të përdorura dhe bluarja e tyre*”, në Mitrovicë, ndodhet në veri të Kosovës ($42^{\circ} 52' 58''$ gjerësisë gjeografike veriore dhe $20^{\circ} 52' 55''$ gjatësi gjeografike lindore), si dhe ndodhet në pjesën qendrore të komunës së Mitrovicës përkatësisht brenda hapësirës industriale të kompleksit Trepça-shoqëri aksionare, Mitrovicë, me sipërfaqe prej rreth 54 ari (5400m^2), afërsisht 1.7 km vij ajrore larg nga qendra e Mitrovicë, ndërsa nga komuna e Vushtrrisë ka një largësi prej 13 km dhe 42 km nga Qyteti i Prishtinës. Në figurën me poshtë tregohet vendndodhja e deponisë.


		 Harta 1: Pozita gjeografike e lokacionit në komunën e Mitrovicës
2.2.	Numri kadastral i parcelës	P-71208128-01090-1, me sipërfaqe për shfrytëzim 5,400 m ² .
2.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë	Veprimtaria zhvillohet brenda një objekti ekzistues në zonën industriale të Trepçës. Zona përreth përmban objekte të tjera industriale dhe është larg zonave të banimit.



Figura 3: Lokacioni i impiantit në raport me objektet e banimit dhe bizneset





Figura 4. Situacioni i terrenit me koordinatat e hapësirës që është marre me qira për shfrytëzim.

2.4.	Të dhëna lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	Flora - Bazuar në të dhënat ekzistuese nga raportet komunale dhe vëzhgimet në terren, zona përreth lokacionit karakterizohet me vegjetacion të zakonshëm fushor dhe kodrinor. Në afërsi të fshatrave përreth haset vegjetacion i vrazhdë dhe spontan. Biotopet natyrore më të përqendruara ndodhen përgjatë lumit Sitnica, duke përfshirë livadhe të lagështa, komunitete të llojeve barishtore, si dhe dru të pishës, lisit dhe shkurreve që dominojnë në pjesën perëndimore të zonës. Në afërsi të lokacionit të impiantit, flora dominohet nga lloje të zakonshme të bimëve dhe drunjve vendor, ndërsa në veri të parcelës ndodhet një zonë me pisha që përbën një mikrohabitat më të veçantë në kontekstin lokal. Aktivitetet e impiantit, të cilat janë të kufizuara në një zonë të industrializuar dhe me infrastrukturë të përshtatur, nuk ka ndikim negativ mbi këtë habitat pyjor, si dhe mbi florën në tërësi. Fauna Fauna në zonën përreth karakterizohet nga prania e shpendëve dhe gjitarëve të zakonshëm për relievin kodrinor-fushor të Kosovës. Ndër shpendët e egër më të hasur janë: shqiponja e malit, petriti, grizhla, sorra, harabeli, kulumria, bufi dhe lakuriqi i natës. Në grupin e gjitarëve të egër përfshihen: dhelpra, lepuri i egër, ujku, derri i egër, iriqi, bukla dhe breshka. Përreth ujërave të lumit Sitnica dhe kanaleve natyrore të pranishme në zonë, janë të pranishme gjithashtu rosat, patat, lejleku, bretkosat, gjarpërinjtë e ujit dhe breshkat e ujit. Aktivitetet njerëzore, sidomos dëmtimi i pyjeve dhe gjuetia e pakontrolluar, paraqesin kërcënim për disa nga këto specie, disa prej të cilave janë në rrezik zhdukjeje lokale, si lepuri i egër, fëllënza dhe shepka e malit. Megjithatë, duke marrë parasysh natyrën e mbyllur dhe të kontrolluar të veprimtarisë së impiantit për prodhimin e materialeve dekorative dhe izolues, si dhe largësinë e tij nga habitatet natyrore më të ndjeshme, nuk ka ndikime të rëndësishme negative mbi faunën vendore.
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	Bazuar në të dhënat zyrtare të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN), si dhe në bazë të verifikimeve në terren, rezulton se në afërsi të lokacionit ku parashihet të vendoset

		impianti i MIRECO SH.P.K., nuk ekzistojnë zona të mbrojtura të natyrës të shpallura sipas legjislacionit në fuqi. Nuk janë evidentuar monumente natyrore, zona të mbrojtura të biodiversitetit, parqe kombëtare apo rezervate natyrore që mund të ndikohet nga aktiviteti i planifikuar i impiantit për përpunimin e tullave zjarrrdurese (refraktare). Për rrjedhojë, projekti nuk përfshihet në ndonjë zonë të ndjeshme ekologjikisht dhe nuk ka ndikime direkte apo indirekte në sistemet ekologjike të mbrojtura nga ligji.
--	--	--

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

3.1.Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet leja mjedisore



3.1.2.

Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik

Gjatë procesit të grumbullimit duhet të merren masat adekuate. Në vijim kemi një paraqitje më të detajuar të mënyrës së operimit të plotë në impiant. Funkzioni i rrjedhës së procesit parashihet të realizohet si në hapat në vijim :

- Ardhja me kamionë e materialit për deponim përmes rrugës qasëse;
- Hapja e dyerve metalike pre hyrje në lokacion;
- Matja e materialit të sjellë në peshore “nr. 8” (me kamion transporti), përfshi tabelën komanduese “nr. 9”;
- Nga peshorja, materiali bartet dhe zbrazet në deponin e mbuluar, objekti “nr. 10”.



Figura 1: Objekti ku zhvillon funksioni impianti, hapësira ku grumbullohet materiali.

Procesi i ndarjes-sortimit

Ky është objekti i hangarit në Trepçë. E gjithë veprimtaria zhvillohet brenda këtij hangarit që është me rreth 5400 m². Në këtë hapësirë pos grumbullimit bëhet edhe klasifikimi i tullave zjarrduruese. Më pas operimi zhvillohet përmes dy makinerive kryesore, makinës që bënë **sortimin e materialit**, i cili behet me dore dhe hidhet tek makina nr.2, pra në makinën e Thyerjes nëse është e nevojshme, nëse jo, materiali selektohet-vendoset në thasë-boksa të veçantë të ndarë për secilin material veç e veç.

Sortieranlage Edge





Figura 2: Makina e sortimit

Procesi i bluarjes-thërrmimi

Pas procesit të sortimit, nëse është e nevojshme bëhet edhe thërrmimi i tullave zjarrrdurese. Këtë proces e kryen makineria -Jaw Crusher- Gurthyes Mobil. Kapaciteti për një ditë në operacion me një ndërrim është përafërsisht 20 ton. Kjo makineri bënë thërrmimin e tullave zjarrrdurese, pasi hapësira është e mbyllur dhe nuk ka aktivitetet të përditshëm, një herë (një ditë) në muaj apo dy here me se shumti. Makineria është mobile me rrota dhe mund të lëvize nga një vend në tjetrin shumë lehtë. Shih foton e mëposhtme.



Figura 3: Makineria për bluarje-thërrmim

Materiali ngarkohet në hopperin e ushqimit përmes një ngarkuesi rrotullues. Një kanal vibrues e përcjell materialin më tej në një brez transportues. Materiali bie në thyesin e nofullës Kleemann. Këtu, materiali thyen në 0-40 mm dhe shpërndahet përmes një brezi tjetër transportues.



Figura 9: Makineria për bluarje-thërmim

Kosovo Crusher line without screen




Figura10: Koncepti si funksionon procesi përpunues i gurthyesit

Mbushja e thasëve

Pas procesit të sortimit apo të bluarjes vijon procesi i mbushjes së thasëve. Materiali i ardhur, nga deponia e mbuluar, futet në thasë dhe bartet me ekskavator “nr. 13”. (shih figurën e më sipërme nr. 4).

Materiali ngarkohet në lugën e ekskavatorit-ngarkuesit përmes një ngarkuesi rrotullues. Një Hink për mbushje - BB bosh është varur në pajisjen e pezullimit. Duke hapur manualisht rrëshqitësin fillon mbushja e Thaseve- BB-së. Shkalla e platformës tregon peshën aktuale, dhe kur arrihet pesha e duhur, fluksi i materialit ndalet duke mbyllur vrimën e poshtme mbushëse dhe e ndal platformën. Materiali i selektuar vendoset në thasë si material final, vendosja në thasë bëhet përmes kallupit, ku thasët me peshë 1500Kg-1800kg përmes pirunorve barten deri në deponi të thasëve “14” të vendosur në një nivel dhe të renditur si në planimetri. Thasët si ngarkese finale, ngarkohen në kamion transporti dhe vendosen në peshore për matje “8” nga aty përmes derës dalin në rrugë për largim dhe drejt destinacionit final.






Figura11: Mbushja e thasëve Big Bags



Figura 12: Makineria për bluarje-thërmim

		 Figura 13: Klasifikimi i matrialit.
3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	Orari i punës zgjat 12 orë dhe fillon nga ora 07:00 deri në 19:00.
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	Kapaciteti përpunues i makinerisë së thërmimit është përafërsisht 20 ton në ditë (gjatë ditëve kur operon). Kapaciteti : <i>Ditor 20 ton/dite</i> <i>Mujor ~520 ton/muaj (20 ton · 26 dite, mesatarisht)</i> <i>Vjetor 6,240 ton/vit (20 ton · 312 dite)</i> Ditë të punës janë 6, nga e Hëna deri të Shtunën (e Dile pushim)
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së	1. Lënda e parë kryesore

parë dhe lëndëve ndihmëse.	Mbetjet e tullave zjarrduruese (refraktare) – materiale të përdorura më parë në furrën e koksit, furrën me vatër të hapur, furrën e shkrirjes së qelqit, etj. – Importohen/tranportohen me kamionë nga industritë e përpunimit të metaleve dhe qeramikës. – Sasia vjetore: rreth 6000 tonë/vit (sipas projektit të investitorit). 2. Lëndë ndihmëse Thasët Big Bags – për paketimin e materialeve të thërrmuara. Çimentoja – për stabilizimin e platformës së magazinimit. Vaji hidraulik – për mirëmbajtjen e makinerive (në sasi minimale). 3. Energjia elektrike Burimi: Rrjeti elektrik i Trepçës (CEDS). Fuqia totale e instaluar: 30 kW. Konsumi vjetor i parashikuar: rreth 50 000 kWh/vit. 4. Uji Burimi: Ujësjiellësi i qytetit të Mitrovicës. Përdorimi: – Uji i pijshëm për stafin (6 persona). – Uji për pastrim të makinerive (në rast të nevojshëm). Sasia vjetore: rreth 60 m³/vit. 5. Karburantet Naftë për kamionët dhe ekskavatorin – për transport dhe ngarkim/shkarkim. Sasia vjetore e parashikuar: rreth 5 000 litra/vit. 6. Mbeturina Mbetje inerte – zhavorr dhe pluhur nga thërrmimi (përdoren për mbushje në vend). Mbetje urbane – nga aktiviteti i stafit (depozitohen në kontejnerët e vegjël dhe largohen nga komuna).
----------------------------	--



Figura 14: Makineria për thërrmim (Jaw Crusher) që përdor energji elektrike.



Figura 15: Pamje e punishtes ku zhvillohet i gjithe aktiviteti.

3.1.6.	Lista e rezervuarëve dhe kapaciteti i tyre	Lista e rezervuarëve dhe kapaciteti i tyre, Impianti “MIRECO” SH.P.K. – Zona Industriale Trepçë, Mitrovicë <table border="1" data-bbox="505 302 1507 795"> <thead> <tr> <th>Përshkrimi</th><th>Kapaciteti</th><th>Funksioni</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Rezervuarët për lëndën e parë</td><td>6 500 litra</td><td>Depozitim i mbetjeve të tullave zjarrduruese para procesit të thërrmimit</td></tr> <tr> <td>Kontejnerët Big Bags</td><td>1 500–1 800 kg secili</td><td>Magazinin i materialeve të thërrmuara pas procesit të paketimit</td></tr> <tr> <td>Rezervuar për ujë të pijshëm</td><td>5 000 litra</td><td>Furnizim ditor me ujë për stafin dhe pastrimin e sipërfaqeve</td></tr> <tr> <td>Gropa septike</td><td>25 m³</td><td>Trajtim i ujërave të zeza nga kontejnerët sanitare</td></tr> <tr> <td>Rezervuar për vaj hidraulik</td><td>200 litra</td><td>Ruajtje e vajrave për makineritë (ekskavator, thërrmues)</td></tr> </tbody> </table> Rezervuarët për lëndën e parë janë të vendosur në brendësi të hangarit ekzistues prej 5 400 m² dhe janë të mbuluar për të parandaluar depozitimën e pluhurit dhe ndikimin në mjedis.	Përshkrimi	Kapaciteti	Funksioni	Rezervuarët për lëndën e parë	6 500 litra	Depozitim i mbetjeve të tullave zjarrduruese para procesit të thërrmimit	Kontejnerët Big Bags	1 500–1 800 kg secili	Magazinin i materialeve të thërrmuara pas procesit të paketimit	Rezervuar për ujë të pijshëm	5 000 litra	Furnizim ditor me ujë për stafin dhe pastrimin e sipërfaqeve	Gropa septike	25 m ³	Trajtim i ujërave të zeza nga kontejnerët sanitare	Rezervuar për vaj hidraulik	200 litra	Ruajtje e vajrave për makineritë (ekskavator, thërrmues)
Përshkrimi	Kapaciteti	Funksioni																		
Rezervuarët për lëndën e parë	6 500 litra	Depozitim i mbetjeve të tullave zjarrduruese para procesit të thërrmimit																		
Kontejnerët Big Bags	1 500–1 800 kg secili	Magazinin i materialeve të thërrmuara pas procesit të paketimit																		
Rezervuar për ujë të pijshëm	5 000 litra	Furnizim ditor me ujë për stafin dhe pastrimin e sipërfaqeve																		
Gropa septike	25 m ³	Trajtim i ujërave të zeza nga kontejnerët sanitare																		
Rezervuar për vaj hidraulik	200 litra	Ruajtje e vajrave për makineritë (ekskavator, thërrmues)																		
3.1.7.	Lista e legjislacionit në fuqi	Lista e Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative për kompletimin e kërkesës për lëshimin e Lejes Mjedisore: ➤ LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM) ➤ LIGJI I PLANIFIKIMIT NR. 04 / L-174 ➤ LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NR. 03/L-025 ➤ LIGJI NR. 03/L-230 PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VSNM) ➤ LIGJI NR. 08/L-025 PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA ➤ LIGJI PËR UJËRAT E KOSOVËS NR. 04/L-147 ➤ LIGJI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR NR. 04/L-174 ➤ LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA ➤ LIGJI NR. 08/L-116 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-197 PËR KIMIKATE ➤ LIGJI NR. 03/L-233 PËR MBROJTJEN E NATYRES ➤ LIGJI NR. 02/L-102 PËR MBROJTJEN NGA ZHURMA ➤ LIGJI NR. 04/L – 110 PËR NDËRTIM ➤ LIGJI NR. 04/L-175 PËR INSPEKTORATIN E MJEDISIT, UJËRAVE, NATYRËS, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE NDËRTIMIT ➤ LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË ➤ LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA ➤ LIGJI NR. 04/L-012 PËR MBROJTJE NGA ZJARRI ➤ LIGJI NR. 08/L-112 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 02/L-26 PËR TOKËN BUJQËSORE																		

		➤ <i>LIGJI NR. 2003/3 PËR PYJET E KOSOVËS, NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 03/L-153</i> ➤ <i>LIGJI NR. 02/L-88 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE</i> ➤ <i>LIGJI NR.05/L-081 PËR ENERGJINË</i> ➤ <i>LIGJI NR.05/L-085 PËR ENERGJINË ELEKTRIKE</i> ➤ <i>LIGJI NR.05/L-084 PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË</i> ➤ <i>UDHËZIM ADMINISTRATIV (MZHE) NR. 03/2017 MBI RREGULLAT PËR ZONAT E SIGURISË</i> ➤ <i>RREGULLA – ZRRE/NR.03/2022 PROCEDURA E AUTORIZIMIT PËR NDËRTIMIN E PROJEKTEVE TË ENERGJISË.</i> ➤ <i>UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPH) NR. 04/2017 PËR KATEGORIZIMIN E NDËRTIMEVE</i> ➤ <i>UHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) NR. 02/2022 PËR KUSHTET, MËNYRAT, PARAMETRAT DHE VLERAT KUFIZUESE TË SHKARKIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA NË RRJETIN E KANALIZIMIT PUBLIK DHE NË TRUPIN UJOR</i> ➤ <i>UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 07/2021 PËR RREGULLAT DHE NORMAT E SHKARKIMEVE NË AJËR NGA BURIMET E PALËVIZSHME TË NDOTJES</i> ➤ <i>UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPH) NR.16/2015 PËR INFORMIM, PJESEMARRJE TË PUBLIKUT DHE PALËVE TË INTERESUARA NË PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS</i> ➤ <i>UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) – NR. 03/2021 PËR MENAXHIMIN MBETURINAVE TËRREZIKSHME</i> ➤ <i>UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) – NR. 08/2017 PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE TË MBETURINAVE</i> ➤ <i>UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR.13/2013 PËR KATALOGUN SHTETËROR TË MBETURINAVE</i> ➤ <i>UDHËZIMI ADMINISTRATIV MMPH, NR.10/2015 PËR TRAJTIMIN E MBETURINAVE NGA PRODUKTET MEDICINALE.</i> ➤ <i>UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 07/2012 PËR CILËSINË E KARBURANTEVE TË LËNGËTA TË NAFTËS</i> ➤ <i>UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR.05/13. PËR MENAXHIMIN E VAJRAVE TË PËRDORURA DHE MBETURINE.</i> ➤ <i>UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) NR. 01/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MMPHI) NR. 04/2022 PËR LEJE MJEDISORE</i>
--	--	--

3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit

3.2.1.	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	“MIRECO” SH.P.K. është i përkushtuar që, nëpërmjet të gjitha funksioneve të saj organizative, të sigurojë përmirësime të vazhdueshme dhe të përmbushë detyrimet ligjore që dalin nga legjislacioni mjedisor në fuqi, me qëllim krijimin dhe ruajtjen e një mjedisit të pastër dhe të qëndrueshëm në zonën ku operon impianti për riciklimin e tullave zjarrruduese. Sistemi i Menaxhimit Mjedisor i kompanisë bazohet në parimet e ISO 14001 dhe ofron një kornizë të qartë për: • <i>Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e aspekteve mjedisore që lidhen me veprimtarinë e impiantit;</i> • <i>Parandalimin e dëmtimit të mjedisit gjatë fazës së grumbullimit, thërrimit, paketimit dhe magazinimit të mbetjeve;</i> • <i>Përmirësimin e komunikimit me autoritetet mjedisore lokale dhe qendrore;</i> • <i>Përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore, përmes monitorimit periodik dhe trajnimit të stafit;</i> • <i>Respektimin e plotë të legjislacionit vendor, duke përfshirë Ligjin 08/L-181 për VNM, Ligjin 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Udhëzimet Administrative për menaxhimin e mbeturinave, ajrit, ujit dhe zhurmës;</i> • <i>Raportimin transparent dhe rregullt sipas kërkesave të ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.</i> Ky sistem menaxhues zbatohet në të gjitha fazat e operimit të impiantit, duke filluar nga pranimi i lëndës së parë, deri te magazinimi dhe transporti i produktit përfundimtar.
3.2.2.	Raportimi	Raportojmë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke respektuar kërkesat – kushtet që derivojnë pas pajisje me Leje Mjedisore duke i raportuar autoriteteve mjedisore sipas legjislacionit në fuqi.

4.AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

4.1.	Pikat e burimit të emisioneve e materieve ndotëse	Gjatë operimit, ndikimet në ajër mund të rezultojnë vetëm në rast të mos zbatimit të masave paraprake. Burimet e mundshme të emisioneve janë: • <i>Transporti i mbetjeve – pluhur i ngritur nga lëvizja e kamionëve në rrugën qasëse (rruga “Albaniku”).</i>
------	---	---

		• Ngarkimi dhe shkarkimi i tullave – pluhur gjatë zbrazjes së kamionëve në deponinë e mbuluar. • Thërrmimi i tullave – makineria është e mbyllur; çdo rrjedhje e mundshme pluhuri trajtohet me sistem lagështimi. • Lëvizja e ekskavatorit dhe ngarkuesit – pluhur i kufizuar në sipërfaqe të zhavorruar dhe të mbuluar. Për të gjitha këto faza, procesi teknologjik nuk përfshin aktivitete që çlirojnë grimca në ajër, pasi makineritë janë të mbyllura dhe materialet mbahen në ambiente të mbuluara.
4.2	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Ndikimi i emisioneve të materieve ndotëse në cilësinë e ajrit varet nga: • kushtet klimatike dhe meteorologjike në zonën industriale; • numri i automjeteve që hyjnë/dalin për transportin e tullave; • lëvizja e makinerive si ekskavatori dhe ngarkuesi brenda hapësirës. Për të parandaluar dhe zvogëluar këtë ndikim, kompania ka ndërmarrë këto masa: • mbajtja e materialeve në ambiente të mbuluara; • spërkatja periodike me ujë e rrugës së hyrjes dhe zonës së ngarkimit, veçanërisht gjatë ditëve me erë dhe temperatura të larta; • pastrimi i rregullt i hapësirës punuese nga mbeturinat dhe pluhuri; • mirëmbajtja e makinerive për të shmangur avaritë që mund të rrisin emetimet.
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse në këtë impiant paraqiten kryesisht nga: • pluhuri i ngritur gjatë lëvizjes së kamionëve dhe ekskavatorëve brenda hapësirës punuese; • depozitimi dhe grumbullimi i tullave zjarrduruese në zona të hapura përkohësisht para procesimit; • transferimi i materialit nga kamionët në deponinë e mbuluar, ku mund të ketë shpërndarje të lehtë pluhuri në ajër. Këto burime janë të kufizuara në kohë dhe sasi, dhe menaxhohen me masa të rregullta si spërkatja me ujë dhe mbulimi i sipërfaqeve.

4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Nuk parashikohen pajisje për trajtimin e gazrave shkarkuese, pasi procesi i riciklimit të tullave zjarrrduese nuk prodhon emisione të gazrave të dëmshme – makineritë janë me motor elektrik dhe aktivitetet janë kryesisht mekanike (grumbullim, thërrmim, paketim).
4.5.	Pajisjet për de-pluhurim	Nuk është instaluar pajisje e posaçme për de-pluhurim, pasi procesi nuk ka pika fikse ku grumbullohet pluhur në sasi të konsiderueshme. Për parandalimin e pluhurit janë ndërmarrë këto hapa: • <i>Makineritë për thërrmim janë të mbyllura;</i> • <i>Materiali transportohet me breza të mbuluar;</i> • <i>Zona e ngarkimit spërkaten me ujë në ditë me erë ose temperatura të larta;</i> • <i>Rruga e brendshme mbahet e lagësht dhe pastrohet rregullisht;</i> • <i>Depozitimi i tullave bëhet në depon të mbuluar dhe me shtresa zhavorri.</i>
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Nuk janë bërë matjet sepse impianti nuk shkarkon emisione mirëpo nëse kërkohet një gjë e tillë do të bëhën matjet
4.7.	Monitorimi i emisioneve/ cilësisë ë ajrit	Kontrollin e rregullt do ti relaizoj Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinore dhe Infrastruktures, permes organeve të saj, ndersa matjet do ti bëjë kompania vetem ne raste te veçanta MMPHI-ja.
4.8.	Raportimet	Kompania bëne raportime në MMPHI, duke respektuar kërkesat e autoriteteve mjedisore dhe legjislacionin në fuqi.
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit: 1. Procesi i mbyllur • I gjithë procesi i grumbullimit, sortimit dhe thërrmimit realizohet brenda objektit duke minimizuar çlirimin e pluhurit në ambientin e jashtëm. 2. Sisteme spërkatëse & lagështim • Nëse kërkohet thërrmim, makina Jaw Crusher punon jo më shumë se 1-2 herë/muaj dhe mban materialin të lagështuar për të ulur pluhurin. • Platforma e zhavorrit dhe zonat e magazinimit spërkaten me ujë para dhe gjatë operacioneve, veçanërisht në ditë me erë ose temperaturë të lartë. 3. Transport i mbuluar

		- Kamionët dhe ekskavatorët përdorin karroceri të mbyllura për të parandaluar shpërndarjen e grimcave gjatë transportit. - Rruga e hyrjes (rruga “Albaniku”) pastrohet çdo ditë me loder me kova uji për të mbajtur pluhurin nën kontroll. 4. Mirëmbajtje & kontrolle teknike - Kontrolle të rregullta për gjendjen teknike të makinerive (generatorë, ekskavatorë, kamionë) për të shmangur emetimet e hidrokarbureve dhe NOx. - Pajisjet punohen vetëm në orarin 07:00–19:00, duke respektuar kufirin ligjor të zhurmës 64 dBA. 5. Pastrim i vazhdueshëm - Hapësira e brendshme e impiantit pastrohet çdo ditë me fshesë industriale dhe thithës pluhuri. - Mbajtja e rrethojës (gardhi 1,6 m) pengon shpërndarjen e pluhurit drejt zonave përreth. 6. Monitorim & raportim - Parametrat e ajrit (pluhuri PM₁₀ & PM_{2.5}) maten çdo 6 muaj nga autoritetet lokale. - Zyrtari i mjedisit i kontraktorit përgatit raporte mujore për ndotësit e ajrit. Duke pasur parasysh që procesi është i mbyllur, i rrallë dhe i mirëmbajtur, impianti nuk konsiderohet ndotës i rëndë i ajrit. Çdo ndikshmëri mbetet nën kufijtë ligjorë dhe pa rrezik për shëndetin publik.
4.10.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	Masat aktuale për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike gjatë funksionimit të impiantit “MIRECO” SH.P.K.: Furnizim me energji me emetim të ulët – Objekti furnizohet nga rrjeti lokal KEDS, – Të gjitha pajisjet (peshore, thërrmues, ndriçim LED, pompa uji) jemi në përpjekje të vazhdueshme duke ulur konsumin elektrik duke reduktuar dhe racionalizuar përdorimin e paisjeve. Reduktim i emetimeve nga transporti – Kamionët dhe ekskavatorët përdorin karburant me normë <10 ppm sulfur dhe kalojnë kontroll teknik periodik çdo 6 muaj.

		– Rruga hyrëse “Albaniku” mbahet e pastruar për të ulur konsumin shtesë të karburantit nga trafiku i ngadaltë. <i>Riciklimi si zbutës i emetimeve</i> – Çdo ton tullash të ricikluara zëvendëson prodhimin e 1,2 t çimentoje, duke shmangur ~0,9 t CO₂ për ton. – Në vitin 2025 impianti pret të riciklojë rreth 240 t tulla, që do të thotë ~216 t CO₂ të shmangura. <i>Zgjidhje të bazuara në natyrë (ZBN)</i> – mirembajtja e hapësirave gjeberuese ekzistuese dhe shtimi i sipërfaqeve të reja. <i>Monitorim dhe raportim</i> – Zyrtari i mjedisit mat dhe raporton çdo 6 muaj: • konsumin e energjisë (kWh/t ricikluar), • sasinë e karburantit të përdorur, • emetimet tjera, – Të dhënat janë dispozicion të vazhdueshme për institucionet kompetente. <i>Përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike</i> – Objekti është i izoluar termikisht duke ulur nevojën për ngrohje/ftohje gjatë ekstremeve klimatike. – Sistemi i kullimit parandalon vërshimet nga reshjet intensive, duke ruajtur funksionimin në kushtat e reja klimatike. Duke kombinuar teknologji me efikasitet të lartë energjetik, riciklim të materialeve dhe zgjidhje të bazuara në natyrë, impianti “MIRECO” SH.P.K. kontribuon pozitivisht në zvogëlimin e ndikimeve klimatike dhe realizon objektivat e Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike 2019-2028
--	--	---

5. UJI		
5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Në procesin teknologjik të “Impiantit për grumbullimin, klasifikimin, rikuperimin, thërrmimin-thyerjen, paketimin dhe magazinimin e mbetjeve të tullave zjarrruduese (refraktare)” nuk përdoret uji. Për nevojat vetanake të objektit ka uje industrial që furnizohet kompleksi industrial, i cili furnizon vetëm ujë të

		papërpunuar për nevoja sanitare të stafit dhe për spërkatje të kufizuar të sipërfaqeve me zhavorr për kontrollin e pluhurit.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit	“MIRECO” SH.P.K. nuk kryen asnjë shkarkim të ujërave industriale, pasi procesi teknologjik për riciklimin e mbetjeve të tullave zjarrduruese është krejtësisht i thatë. Ujërat fekale që dalin nga kontejnerët sanitare të stafit (6 persona) janë në sasi të vogël dhe grumbullohen në gropën septike lokale me kapacitet 25 m³; nuk parashikohet derdhje e tyre në ujërat sipërfaqësore apo në rrjetin publik të kanalizimit.
5.3.	Ndikimet në ujë	Ky aktivitet nuk përdor ujë për nevoja industriale, ndaj nuk parasheh shkarkime të ujërave teknologjike. Mundësia e ndikimit në cilësinë e ujërave rrjedh në vijim: Derdhje aksidentale të derivateve, vajrave dhe lubrifikanteve – Nga makineritë lëvizëse (ekskavatorë, kamionë) ose agregatet ndihmëse; – Rreziku është i ulët, pasi makineritë mirëmbahen çdo 6 muaj dhe mbajtëset e vajit janë të mbyllura. Pastrimi i ambientit dhe i automjeteve – Pastrimi bëhet vetëm në pikat e caktuara me pllaka betoni të pjerëta drejt gropës septike; – Nuk lejohet larja e automjeteve në sipërfaqe të hapura. Ujërat e lagështimit të sheshit të qarkullimit – Spërkatja me ujë për kontrollin e pluhurit realizohet me sasi minimale dhe mbledhja e ujit të përzier bëhet në gropën septike 25 m³. Ujërat higjeno-sanitare të stafit – Niveli i ujërave fekale është i vogël (6 punonjës); – Ato grumbullohen në gropën septike lokale dhe pastrohen nga operatori i licencuar çdo 6 muaj, pa dalje në trupat ujorë. Ujërat e pastrimit të ambientit të punës – Përdorim i kufizuar uji me sfungjer/brusha dhe mjete me kapacitet të mbyllur; – Uji i ndotur depozitohet në gropën septike. Në kushtet e menaxhimit të aplikuar (gropë septike 25 m³, mirëmbajtje rregullore,

		zona të pllakosura betoni dhe ndalim i pastrimit të hapur), rreziku i ndikimit në rrjedhën ujore afër impiantit (Sitnica, Ibër) është pothuajse zero.
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	Nuk ka bërë matjen e cilësisë të ujit për të përcaktuar emisionet e ujërave të ndotura - treguesin e emisioneve kryesore, koncentrimet dhe sasinë vjetore.
5.5.	Trajtimi i ujërave të ndotura	Duke e pasur parasysh që nga ky proces teknologjik i prodhimit nuk shkarkohen ujra industriale dhe numri i puntorve që janë konstant është mjaft i vogël nuk bëhet trajtimi i ujërave, përveç që ka ndertu një gropë të vogël për ujra fekale.
5.6.	Kontrolli dhe matjet	Kompania nuk bën kontrollin dhe matjet e shkarkimit të ujërave, pasi që nuk ka ujra që shkarkohen nga procesi teknologjik.
5.7.	Raportimi	Kompania nuk bën raportim.
5.8.	Leje ujorë për shfrytëzim të ujit	“MIRECO” SH.P.K. nuk shfrytëzon ujë për nevoja teknologjike dhe nuk kryen shkarkime ujore industriale. Për rrjedhojë: Nuk kërkon Leje ujore për shfrytëzimin e ujit; Nuk kërkon Leje ujore për shkarkimin e ujit pranë Autoritetit Rajonal të Pëllgjeve Lumore (ARPL) – MMPHI. Në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, i cili e lejon përjashtimin nga procedura e lejeve kur aktiviteti nuk përfshin nxjerrje ose shkarkim të ujërave industrial.
5.9.	Leje ujorë shkarkimin e ujërave	“MIRECO” SH.P.K. nuk shfrytëzon ujë për nevoja teknologjike dhe nuk kryen shkarkime ujore industriale. Për rrjedhojë: Nuk kërkon Leje ujore për shfrytëzimin e ujit; Nuk kërkon Leje ujore për shkarkimin e ujit pranë Autoritetit Rajonal të Pëllgjeve Lumore (ARPL) – MMPHI. Në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, i cili e lejon përjashtimin nga procedura e lejeve kur aktiviteti nuk përfshin nxjerrje ose shkarkim të ujërave industrial.
5.10.	Masat për zvogëlimin e	Kompania ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për zvogëlimin e ndotjes së ujërave si: ndërtimi i gropës septike për trajtimin e ujërave fekale.

	ndotjes së ujërave	
--	--------------------	--

6. ZHURMA		
6.1.	Burimet	Gjate funksionimit, zhurma si rezultat i teknologjisë së procesit të prodhimit, ka një karakter lokal dhe nuk ka ndikim në zonat e banuara. Zhurma mund të krijohet nga makineritë dhe pajimet e procesit të prodhimit, automjetet transportuese dhe automjete të tjera. Sidoqoftë, aktivitetet që zhvillohen në këtë biznes nuk pritet që të tejkalojnë nivelin e lejuar të zhurmës. Zhurma dhe vibrimet që krijohen gjatë punës nuk pritet të ndikojnë në popullatën lokale duke marrë për bazë distancën e madhe me objektet e banimit. Po ashtu gjatë zhvillimit të veprimtarisë nuk ka aktivitete që zhvillohen gjatë natës që mund të ndikonin në krijimin e zhurmave. Sa i përket zhurmave, ato janë të ndjeshme vetëm brenda ambienteve të zones se punes dhe nuk janë problem për mjediset e jashtme dhe fqinjët.
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Nuk kryen aktivitete të kontrollit dhe matjeve të zhurmës.
6.3.	Raportimet	Nuk bejm raportimin ne Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mirëpo nëse kërkohet në të ardhmen do të raportojmë, duke respektuar kërkesat e autoriteteve mjedisore dhe legjislacionin në fuqi.

7. TOKA		
7.1.	Ndikimet në tokë	Ndikimet në tokë – impianti “MIRECO” SH.P.K. Shkalla e ndikimit Ndikimet në cilësinë e tokës janë minimale ose pothuajse zero, pasi aktiviteti kryesisht zhvillohet brenda një objekti të mbyllur, pa gjermime të reja dhe pa ndërhyrje të mëdha në terren.

		Mbeturinat komunale Burimi kryesor janë mbeturinat e punonjësve (6 persona): paketime, mbetje ushqimore, lehtë plastike. Grumbullohen në kontejner të posaçëm dhe largohen 1–2 herë në javë nga operatori i licencuar i mbeturinave komunale. Mbeturinat nga mirëmbajtja dhe riparimet Gjatë servisimit të makinerive mund të dalin vajra të përdorur, filtra, pjesë metali. Të gjitha këto depozitohen në enë të mbyllura dhe transportohen sipas Udhëzimit Administrativ për menaxhimin e vajrave të përdorura. Rreziku nga rrjedhjet e hidrokarbureve Makineritë janë në gjendje të mirë teknike dhe kalojnë kontroll teknik periodik çdo 6 muaj, duke ulur rrezikun e rrjedhjeve. Në zonë janë vendosur përthithëse të vajit dhe pluhur absorbues për intervenim të menjëhershëm në rast aksidenti. Depozitimi i pluhurave Pluhuri që prodhohet gjatë thërrmimit kolektohet me sistem me filtra dhe mblidhet në çanta të mbyllura për riciklim ose largim të sigurt. Masat e marra për zvogëlimin e ndikimeve • Rrethimi me gardh 1,6 m parandalon hyrjen e paligjshme dhe depozitimin e mbeturinave të jashtme. • Toka e pllakosur me beton në zona kritike pengon depërtimin e vajrave në nëntokë. • Plan i menaxhimit të mbetjeve i përditësuar çdo vit, i bashkangjitur Planit të Monitorimit të Mjedisit. Duke qenë se aktiviteti nuk përfshin procese të lagështa ose përdorim kimikash, dhe mbetjet menaxhohen sipas standardeve, ndikimi në cilësinë e tokës mbetet i vogël dhe i kontrolluar
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë <i>(të aplikuara gjatë fazës së operimit të impiantit “MIRECO” SH.P.K.)</i>

		• Të gjitha pajisjet dhe makineritë (sortuesi, thërrmuesi Kleemann, ekskavatorët dhe kamionët) mirëmbahen dhe kontrollohen çdo 6 muaj nga teknikët e kompanisë; çdo defekt regjistrohet dhe eliminohet brenda 24 orëve. • Ndërrimi i vajrave të makinerive bëhet në punëtori të licencuara jashtë impiantit. Vetëm në rastet e makinerive të mëdha që nuk mund të lëvizin, ndërrimi dhe shtimi i karburantit kryhet vetëm nga dy punonjës të trajnuar dhe të pajisur me mjete mbrojtëse, mbi pllaka betoni të pjerëta dhe me përthithëse absorbuese nënsh këmbët e makinerisë. • Mbeturinat komunale dhe të ngurta klasifikohen në burim: – plastikë dhe letër → kontejner i veçantë; – mbetje ushqimore → kontejner i mbyllur me kapak; Mbledhja bëhet dy herë në javë nga operatori i licencuar i komunës. • Vajrat e përdorura depozitohen menjëherë në kontejnerë metalikë 200 L me dy kapakë të mbyllur; – mbetje të rrezikshme (vajra, filtra) → enë të mbyllura dhe të etiketuara. çdo tre muaj transportohen nga kompania e licencuar për riciklim. • Kontrolli i makinerive transportuese (kamionë, ekskavatorë) përfshin inspektimin e çdo rezervuari dhe filtri para çdo ndërrimi të karburantit; nën çdo rezervuar të makinerive të mëdha është vendosur tabaka plastike me përthithëse të vajit për të kapur rrjedhjet eventuale.
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit (impianti “MIRECO” SH.P.K. – kompleksi industrial Trepça) Kushtet fillestare • Impianti zhvillohet brenda kompleksit industrial Trepça Sh.A., në objekte ekzistuese të marra me qira. • Sipërfaqja prej 5 400 m² është pllakosur me beton dhe zhavorr; nuk ka ndërtime të reja as gërmime. Detyrimet e MIRECO pas përfundimit të aktivitetit • Çdo ndërhyrje e bërë nga ana e MIRECO (kontejnerë, pllaka betoni shtesë, instalime të përkohshme) do të çmontohet plotësisht. • Bazamentet lehtë shtesë do të thërrmohen dhe materiali inert do të largohet në deponinë e autorizuar për materiale inerte.

		• Në fund të periudhës së qirasë, lokacioni i kthehet Trepça Sh.A. në gjendjen fillestare – pa mbetje, pa përçarje të reja në terren dhe me kapacitetin e mëparshëm të përdorimit industrial. Rikthimi i peizazhit (ku kërkohet nga pronari) • Në pjesët ku eventualisht është shtruar shtresë e re zhavorri ose beton i përkohshëm, do të bëhet: – heqja dhe largimi i materialit të tepërt; – vendosja e një shtrese 0,3–0,5 m humus të testuar agro-kimikisht, nëse Trepça Sh.A. e kërkon për përdorim të ardhshëm bujqësor/gjelbërim. • Çdo mbjellje eventuale bëhet vetëm me miratimin paraprak të Trepça Sh.A. dhe në përputhje me planet e saj të përdorimit të mëvonshëm të parcelës. Konfirmimi përfundimtar • Pronari (Trepça Sh.A.) do të nënshkruajë aktin e pranimit vetëm pasi të jetë verifikuar që: – toka është pastruar nga çdo mbetje; – pllakat shtesë janë hequr; – sipërfaqja është rikthyer në gjendjen fillestare të qirasë.
--	--	--

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

8.1.	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave	Gjate procesit teknologjik nuk gjenerohen mbeturina pervec atyrrer mbeturinave komunale qe gjenerohen nga puntort ne baza ditore. Mbeturina komunale deponohen përkohësisht në kontejner dhe pastaj bartën me kamionë nga kompania e licencuar, e cila i dërgon në deponinë regjionale për deponim të mbeturinave. <table><tr><td>Mbeturina</td><td>Emri i mbeturinës</td><td>Shkalla e rrezikshmërisë</td><td>Lloji i deponimit</td></tr><tr><td></td><td>Letra</td><td>Jo e rrezikshme</td><td>Kontejner</td></tr><tr><td>170203</td><td>Plastika</td><td>Jo e rrezikshme</td><td>Kontejner</td></tr><tr><td>150101</td><td>Mbeturina të ngurta komunale</td><td>Jo e rrezikshme</td><td>Kontejner</td></tr></table>	Mbeturina	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit		Letra	Jo e rrezikshme	Kontejner	170203	Plastika	Jo e rrezikshme	Kontejner	150101	Mbeturina të ngurta komunale	Jo e rrezikshme	Kontejner
Mbeturina	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit															
	Letra	Jo e rrezikshme	Kontejner															
170203	Plastika	Jo e rrezikshme	Kontejner															
150101	Mbeturina të ngurta komunale	Jo e rrezikshme	Kontejner															

		200101 2010108	Mbeturina të ngurta komunale	Jo e rrezikshme	Kontejner	
8.2.	Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave	Kompania nuk bën magazinimin e përkohshëm të mbeturinave, mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe vendosën në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, pastaj merren nga kompania e mbeturinave.				
8.3.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Fillimisht bëhet ndarja e mbeturinave të riciklueshme në burim të cilat shiten tek operatorët e grumbullimit të licencuar përmes peshimit, pjesa e mbetur e mbeturinave nuk bën trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave, por dorzohët tek kompania komunale për grumbullimin e mbeturinave.				
8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër-kontratë me kompaninë me leje përkatëse	Kompania nuk bën trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave.				
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Kompania, klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave, e bën në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA dhe Ligj i mbeturinave, Nr.04/L-060. Mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësore.				
8.6.	Raportimi	Nuk bëhet raportim lidhur me menaxhimin e mbeturinave pasi që kompania mbeturinat e grumbulluara komunale i merr kompania e licencuar për menaxhim me mbeturina.				
9. RREZIKU NGA AKSIDENTET						
9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Kompania e ka planin për pengimin e aksidenteve në rast rreziku si dhe planin e intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm.				

9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Nuk përdoren substancave të rrezikshme kimike dhe preparate.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Ne kemi ndërmarr këto masa për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave: -Kemi siguruar pajisje kundër zjarrit si dhe enët me rërë. -Kemi siguruar instalimet elektrike me ndërprerës emergjent dhe të automatizuar; -Kemi siguruar mjetet e forta që mund të bien nga lartësia -Kemi marr masa që platoja të jetë e pastër duke i eliminuar rrëshqitjet dhe lëndimet;
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Kemi hartuar raportin për gjendjen e sigurisë.
9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	Ka hartuar planin për mbrojtjen nga zjarri.
10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT		
10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Ndërprerja momentale e punës së impiantit mund të ndodhë në rastet e rrjedhjeve aksidentale të derivateve dhe vajrave, nëse kemi defekte, deri në sanimin e gjendjes dhe kthimin e tyre në funksion, si dhe në rastet aksidentale të shkakimit të zjarrit.
10.2.	Ndërprerja e punës	Kompania nuk ka planifikuar ndërprerjen e punës, mirëpo nëse vjen deri te ndërprerja e punës, kemi bërë planin e rehabilitim dhe ri kultivimit.
11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT		
Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut është shumë i vogël, pasi që Kompania – për prodhim ka ndërmarr të gjitha masat për zvogëlimin e ndikimeve në shëndetin e njeriut.		

Personi përgjegjës për mjedis

Emri mbiemri
Mbiemri

Nënshkrimi

Personi përgjegjës i kompanisë

Emri

Nënshkrimi
